



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

nr. 403 , datë 23.02.2016

**“Mbi detyrimin e ndërmarrjes GFI Albania Sh.p.k për depozitimin e pasqyrave
financiare të shoqërisë Petroleum Consulting Partners A.G ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Zv. Kryetar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Iva Zajmi Anëtar
- Z. Eduard Ypi Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 23.02.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Detyrimin e ndërmarrjes GFI Albania Shpk për depozitimin e pasqyrave financiare të shoqërisë Petroleum Consulting Partners A.G

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti neni 33.2 “Detyrimi për të informuar”(Ligjit) .

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm për kërkimin e të dhënave me vendim Komisioni në lidhje me vlerësimin e transferimit të 99.9% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GFI Albania Sh.p.k nga Global Fluids International S.A tek Petroleum Consulting Partners A.G.

V Ë R E N S E:

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të njoftimeve nga media dhe pas verifikimit të informacionit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit mbi transaksionin e përfutimit të 99.9% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GFI Albania Sh.p.k nga Global Fluids International S.A tek Petroleum Consulting Partners A.G., i realizuar më datë 01.09.2015, filloi procedurën e kontrollit të përqendrimit.

Sipas nenit 10 dhe 12 të Ligjit, çdo përqëndrim i realizuar duhet të marrë autorizimin e Komisionit të Konkurrencës në rastet e plotësimit të kriterëve lidhur me ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit dhe kufirit të xhirove të realizuara në tregun e brendshëm dhe tregun ndërkombëtar.

Shoqëria GFI Albania Shpk me shkresën nr. 467 prot, datë 14.12.2015 është njoftuar në lidhje me detyrimin për njoftim të përqendrimit si pasojë e transaksionit të ndodhur me anë të përfutimit të 99.9% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë GFI Albania Sh.p.k nga Global Fluids International S.A tek Petroleum Consulting Partners A.G., i realizuar më datë 01.09.2015. Ky informacion është vërtetuar nga të dhënat e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Me anë të kësaj shkrese Sekretariati i ka kërkuar shoqërisë marrëveshjen e transferimit të kuotave nga Global Fluids International S.A tek Petroleum Consulting Partners A.G, pasqyrat

financiare të audituara të vitit 2014 për shoqërinë GFI Albania Sh.p.k, për shoqërinë Global Fluids International S.a, për shoqërinë Eurocontrol Technics Group Inc., dhe për shoqërinë Petroleum Consulting Partners A.G, si dhe statutet e shoqërive Global Fluids International S.a, Eurocontrol Technics Group Inc. dhe Petroleum Consulting Partners A.G.

Me shkresën nr. 467/4 prot, datë 18.01.2016, shoqëria GFI ka paraqitur marrëveshjen e transferimit të kuotave nga ortaku Global Fluids International S.A tek ortaku Petroleum Consulting Partners A.G, pasqyrat financiare të audituara të vitit 2014 për shoqërinë GFI Albania Sh.p.k dhe statutet e Petroleum Consulting Partners A.G dhe Global Fluids International S.a

Informacioni i protokolluar nuk është i plote pasi nuk mundeson vlerësimin e kriterit të xhiros për tregun nderkombetar, prandaj Sekretariati me shkresën nr. 467/5 prot., datë 22.01.2016, ka kërkuar sërish nga GFI Albania pasqyrat financiare të Global Fluids International S.a, Eurocontrol Technics Group Inc. dhe Petroleum Consulting Partners A.G.

Megjithëse është ezauruar afati i parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe kërkesa është bërë sipas nenit 33 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nga ana e ndërmarrjes GFI Albania nuk është kthyer përgjigje duke penguar vlerësimin e kriterit të xhiros sipas nenit 12 të Ligjit për autorizimin e këtij përqendrimi.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d) dhe nenit 33, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

1. Të kërkojë nga shoqëria GFI Albania Sh.p.k depozitimin e pasqyrave financiare për vitin financiar 2014 për shoqërinë Petroleum Consulting Partners A.G.
2. Mos përmbushja e kërkesave të diapozitivit të këtij Vendimi do të sillte ndëshkimin me gjobë të GFI Albania Sh.p.k, sipas Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA
()
Zv. Kryetar

Koço BROKA
()
Anëtar

Iva ZAJMI
()
Anëtar

Eduard YPI
()
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R